



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 440/1 Prishtinë 15.02. 2023

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti **Arton Morina** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Projektimi sizmik i sistemeve me mure ductile nga betoni i armuar** ” në programin e studimeve Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Pasi që tërmetet janë të paparashikueshme ato ndikojnë drejtëpërdrejtë në stabilitetin e strukturës dhe jetëgjatësinë e saj, nga kjo shtrohet nevoja e projektimit dhe realizimit të ndërtimeve rezistuese ndaj kësaj fatkeqësie natyrore. Studimi i bërë në këtë temë bën përpjekje për të realizuar reagimin sizmik të strukturave ndaj tërmetit. Strukturat më të rrezikuara ndaj tërmetit janë ato struktura të cilat janë të parregullta në plan, në lartësi si dhe jashtëqendërsia mes qendrës së masës dhe qendrës së shtangësisë është më domethënëse në sjelljen përdredhëse të strukturave gjatë një tërmeti. Dëmtimet më të shpeshta strukturore deri tek shkatërrimet e strukturave vijnë nga përdredhja asimetrike e ndërtimeve.

Projektimi i strukturave në zonat sizmike kërkon, që struktura të jetë e thjeshtë, në mënyrë që të jetë e qëndrueshme ndaj ndikimeve horizontale (tërmetit), kjo bën që inxhinierët të projektojnë forma të përshtatshme për analizë. Kjo temë shtjellon pjesën teorike, rregullat e përgjithshme të projektimit sizmik i sistemeve me mure duktile nga betoni i armuar sipas EC-8.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.